

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6727
E hënë, 10 tetor 2022
çmimi 0.40

Si mund t'i merrni fondet e Qeverisë për ngrohje eficiente?



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

VAZHDON PUNIMET SEMINARI I 102-të ROSE-ROTH I ASAMBLESË PARLAMENTARE TË NATO-S

E ARDHMJA E BALLKANIT PERËNDIMOR, ANËTARËSIMI NË INSTITUCIONET E BE-së



Edhe të dielën në Prishtinë ka vazhduar punimet Seminari i 102-të Rose-Roth i Asamblesë Parlamentare të NATO-s, ku u diskutua për situatën në Kosovë ndër vite dhe gjendjen aktuale, si dhe informimit lidhur me situatën në

rajon, duke përfshirë këtu luftën mes Rusisë dhe Ukrainës dhe krizën energjetike. Në këtë seminar u tha se ardhmja e Ballkanit Perëndimor është anëtarësimi në institucionet e BE-së

AKTUALE

KURTI OPTIMIST PËR MARRËVESHJE KOSOVË-SERBI, PAS "QASJES SË RE" F. 3

TURQIA PRET MË SHUMË TURISTË NGA EVROPA KËTË DIMËR F. 2

KOREJA VERIORE TESTON EDHE DY RAKETA BALISTIKE F. 2



EKONOMI



PDK-ja: KOSOVA PO ZBRAZET E PO VARFËROHET, QEVERIA KURTI PO JETON JASHTË REALITETIT EKONOMIK F. 7

MBI 1 000 PUNËTORË TË KEK-ut FITOJNË KONTESTIN PËR PAGA SHITESË PËR ORËT E PUNËS GJATË FUNDJAVËS F. 7

SPORT



SHORT I FAVORSHËM PËR KOSOVËN F. 10

PECI: KOMUNITETI SERB NË VERI NË KONTROLL TË GRUPEVE KRIMINALE

'SHKATËRROHET' NJË BANDË E SHQIPTARËVE PAS ARRESTIMEVE NË SPANJË



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht -Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Turqia pret më shumë turistë nga Evropa këtë dimër

STAMBOLL, 9 TETOR - Kompanitë turke të udhëtimit janë duke pritur fluks të turistëve evropianë në muajt në vijim, pas heqjes së kufizimeve të vendosura për luftim të pandemisë së koronavirusit dhe rritjes së çmimeve të energjisë. “Këtë dimër presim më shumë turistë sesa në vitin e shkuar”, ka thënë Cem Polatoglu, zëdhënës i Asociacionit të operatorëve të udhëtimit në Turqi, transmeton dpa.

Ai ka theksuar se gjatë pandemisë, njerëzit nuk kanë shkuar nëpër pushime. “Tani që janë hequr kufizimet, shumë turistë ndihen sikur të jenë ‘liruar nga zinxhirët’”, ka thënë ai.

Përveç kësaj, edhe rritja e çmimeve të energjisë në

Evropë është duke ndikuar në rritje të rezervimeve në sezonin e dimrit, sidomos në rajonet me kosto të lirë, ka shtuar ai. “Është shumë mirë për sektorin e turizmit që turistët evropianë - sidomos pensionistët - preferojnë pushime të gjata në Turqi gjatë muajve të dimrit, për shkak të rritjes së çmimit të gazit natyror”, ka thënë Ali Onaran, udhëheqës i kompanisë që organizon udhëtime me turistë, Prontotour.

Ai ka thënë se të dhënat e tij tregojnë se kërkesa është rritur nga banorët e shteteve si “Gjermania, Anglia dhe Holanda”.

Onaran ka thënë se inkurajon njerëzit të rezervojnë pushime te tyre gjatë muajve të dimrit, pavarësisht inflacionit global.



“Ka zhvillime sikurse rritja e çmimeve të naftës, të energjisë, ka krizë të ushqimit, e cila ndikon në çmime të hoteleve dhe në buxhetin e njerëzve për udhëtime”, ka thënë ai.

Mirëpo pavarësisht këtyre faktorëve, sipas tij, shkalla e rezervimeve është në linjë me pritjet e departamenti për turizëm.

Sipas Polatoglut, një tjetër shtytë për të vizituar Turqinë

është edhe zhvlerësimi i lirës turke në nivel record.

Sipas tij, për disa turistë më të leverdishme janë pushimet në hotele me pesë yje në Turqi, sesa jetesa në Evropë. “Ata janë më rehat se në shtëpi”, ka shtuar Polatoglu.

Sipas Ministrisë turke për Kulturë dhe Turizëm, më shumë turistë kanë shkuar në Turqi në tetë muajt e këtij viti sesa në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

Rreth 29.3 milionë persona besohet se kanë kryer pushimet e tyre në periudhën janar-gusht të këtij viti në Turqi, çka përbën rritje për 108 për qind në krahasim me vitin e kaluar.

Më së shumti udhëtarë janë regjistruar nga Gjermania - 3.9 milionë.

‘Shkatërrohet’ një bandë e shqiptarëve pas arrestimeve në Spanjë

TIRANË, 9 TETOR - Autoritetet britanike kanë “shkatërruar” një bandë të shqiptarëve, që ka dërguar njerëzit nga Spanja në Mbretëri të Bashkuar.

Besohet se migrantët kanë paguar mes 3.000-15.000 euro për të kaluar nga njëri shtet në tjetrin.

Autoritetet britanike kanë arrestuar shtatë persona përgjatë javës.

Zyrtarët e Agjencisë Kombëtare për Krime, me bazë në Spanjë dhe Mbretëri të Bashkuar, kanë punuar me autoritetet spanjolle për këtë rast.

Banda ka kontrabanduar



kryesisht migrantë shqiptarë përmes qyteteve spanjolle, Bilbao dhe Santander, për në

Mbretëri të Bashkuar, duke përdorur barka dhe mjete tjera në rrugë drejt qyteteve

Portsmouth, Sauthampton dhe Liverpool.

Autoritetet britanike dhe ato spanjolle kanë identifikuar 50 njerëz që kanë kaluar në Mbretëri të Bashkuar me ndihmën e kësaj bande, mirëpo Agjencia Kombëtare për Krime ka thënë se shifra e saktë nuk dihet ende.

Sipas saj, migrantët kanë shkuar nga Shqipëria në Spanjë, mirëpo disa janë rekrutuar edhe në kampet afër porteve spanjolle.

Kontrabanduesit u kanë ofruar atyre akomodim dhe ushqim derisa janë nisur për në Mbretëri të Bashkuar.

Shumica e pjesëtarëve të bandës besohet se kanë jetuar në Shqipëri, mirëpo janë arrestuar në Spanjë dhe aty do të gjykohej sipas ligjeve spanjolle.

Përgjatë bastisjeve, hetuesit kanë konfiskuar telefona, kompjuterë, kartela bankare, para të gatshme, dokumente identifikimi dhe pasaporta të kombësive të ndryshme.

Sipas autoriteteve britanike, këtë vit është shënuar shifër rekorde e njerëzve që kanë kaluar Kanalin Anglez me barka të vogla për të hyrë në Mbretëri të Bashkuar - më shumë se 33.500.

Koreja Veriore teston edhe dy raketa balistike

PHENIAN, 9 TETOR - Koreja Veriore ka lansuar dy raketa balistike më 9 tetor, duke çuar në shtatë numrin e raketave që ka testuar në dy javët e fundit.

Raketat kanë rënë në Detin e Japonisë, sipas ushtrisë së Koresë së Jugut.

Shtabi i Përgjithshëm i ushtrisë jugkoreane, i ka konsideruar këto testime si “provokime serioze”.

Garda bregdetare e Japonisë ka thënë se raketat kanë rënë jashtë Zonës ekonomike të Japonisë, dhe se të dyja raketat mund të jenë nisur nga një nëndetëse.

Lajmi për testimet raketore ka ardhur disa orë pasi Shtetet e

Bashkuara dhe Koreja Jugore kanë kryer stërvitjet e përbashkëta ushtarake, në të cilat është përfshirë edhe një aeroplanmbajtës me energji bërthamore.

Zyrtarë verikoreanë kanë arsyetuar testimet e fundit raketore, duke përmendur masat për vetëmbrojtje kundër SHBA-së.

Pheniani ka thënë se testimet raketore nuk përbëjnë kërcënim për shtetet fqinje.

Më 4 tetor, Koreja Veriore ka lëshuar një raketë balistikë mbi Japoni, për herë të parë në pesë vjet.

Shtetet e Bashkuara dhe Japonia kanë dënuar ashpër këtë veprim.



Kurti optimist për marrëveshje Kosovë-Serbi, pas “qasjes së re”

PRISHTINË, 9 TETOR - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë të dielën se është optimist që në muajt vijues do të mund të arrihet një marrëveshje ligjrisht obliguese me Serbinë. Ai i ka bërë këto deklarata në kuadër të seminarit të 102-të Rose-Roth i Asamblesë Parlamentare të NATO-s që është mbajtur këtë herë në Prishtinë.

Në diskutim e sipër me pjesëmarrësit, Kurti ka thënë se në dialogun mes Kosovës dhe Serbisë, që ndërmjetësohet nga Bashkimi Evropian në Bruksel, është krijuar një qasje e re, duke përmendur kornizën e përgjithshme të marrëveshjes. Sipas tij, “dialogu nuk duhet të shërbejë vetëm për menaxhim të krizave, por dialogu duhet të jetë për marrëveshje”.

“Tani jemi futur në një fazë të re, prej 18 gushtit të këtij viti. Kjo është fazë e re sepse tema e parë në zyrën e (kryediplotatit të Bashkimit Evropian, Josep) Borrell në Bruksel ishte korniza e përgjithshme e marrëveshjes. Pra dialogim për marrëveshje, do të diskutojmë kornizën. Tani unë jam shumë më optimist, sepse, krahasuar me të kaluarën, kur njohja e pavarësisë ishte në fund të procesit, dhe po shndërronte këtë çështje në motivim për zvarritje të procesit, tani njohja



e ndërsjellë nuk është në fund, por në qendër të marrëveshjes”. Ai nuk ka përjashtuar edhe diskutimin e temave tjera në kuadër të dialogut, mirëpo ka insistuar që pjesë qendrore është “njohja e ndërsjellë”. Kosova dhe Serbia kanë nisur negociatat për normalizimin e marrëdhënieve më 2011, me ndërmjetësimin e Bashkimit

Evropian.

Procesi i negociatave pritet të përfundojë me marrëveshje ligjrisht të detyrueshme.

Ndonëse Kosova deklaroi se kjo marrëveshje duhet të përfshijë njohjen e ndërsjellë, Serbia nuk pranon, duke insistuar në “zgjidhje kompromisi”.

Përgjatë fjalimit të tij në seminarin me temën, “Integrimi

euro-atlantik i Ballkanit Perëndimor: sfidat e zgjatura, realitetet e reja dhe perspektivat e ardhshme”, Kurti ka thënë ky rajon është shumë i cenueshëm në aspektin e stabilitetit dhe sigurisë.

Mirëpo, sipas tij, “Republika e Kosovës është shumë e qartë në orientimin e saj politik dhe strategjik drejt integrimit në

strukturat euro-atlantike” dhe se Qeveria e Kosovës po punon në përafrim me NATO-n dhe Bashkimin Evropian.

“Ndonëse Kosova nuk është pjesë e NATO-s, NATO-ja është në Kosovë dhe ne jemi pjesë e historisë së njëri-tjetrit, të tanishmes së njëri-tjetrit dhe besoj që edhe të ardhmes së njëri-tjetrit”.

NATO-ja është prezente në Kosovë përmes misionit të saj KFOR.

Autoritetet në Kosovë kanë thënë edhe në të kaluarën se synojnë të jenë anëtare në programin e NATO-s, Partneriteti për Paqe.

Partneriteti për Paqe është një program i NATO-s, që synon krijimin e besimit midis shteteve anëtare të NATO-s dhe shteteve të tjera në Evropë.

Qeveria e Kosovës ka thënë se veçse ka formuar një grup punues për anëtarësimin në këtë program.

Shtetet e Bashkuara kanë mbështetur anëtarësimin e Kosovës në realizim të këtij synimi ndonëse kanë rikujtuar se për një vendim të tillë kërkohet pajtimi i 30 vendeve anëtare të Aleancës.

Nga 30 vende anëtare të NATO-s, Kosovën si shtet të pavarur e kanë njohur 26 prej tyre ndërsa katër (Greqia, Rumania, Sllovakia dhe Spanja) ende jo.

Peci: Komuniteti serb në veri në kontroll të grupeve kriminale

PRISHTINË, 9 TETOR - Ish-ambasadori Lulzim Peci i ka kërkuar Qeverisë së Kosovës që të bëjë më shumë për qytetarët serbë në veri të vendit në mënyrë që të shpëtohen nga kontrolli i, siç i quajti ai, të elementëve të presidentit serb Aleksandër Vuçiq.

Gjatë punimeve të Seminarit të 102-të të Rose-Roth i Asamblesë Parlamentare të NATO-s, me temën “Integrimi euro-atlantik i Ballkanit Perëndimor: sfidat e zgjatura, realitetet e reja dhe perspektivat e ardhshme”, Peci tha se Kurti kishte premtuar dialog me komunitetin serb. “Kryeministri Kurti gjatë fushatës zgjedhore ka premtuar dialog me komunitetin serb në Kosovë, por sipas meje nuk ka hapa të dukshëm e të rëndësishëm që janë ndërmarrë në këtë drejtim nga Qeveria e Kosovës deri tash. Në anën tjetër mosimplementimi i vendimit nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës lidhur me manastirin e Deçanit ka ndikim negativ në ndërtimin e besimit mes



Qeverisë së Kosovës dhe ai. komunitetit serb”, ka pohuar

Peci ka theksuar se

shqetësimet kyçe të serbëve të Kosovës janë, jostabiliteti

politik, migracioni, siguria dhe korrupsioni.

Drejtori i KIPRED u shpreh se në veri ka elemente kriminale që armatosen nga vetë presidenti i Serbisë, për këtë gjë tha se nuk e fsheh më as vet Aleksandër Vuçiq. “Kjo për faktin se politikat e Serbisë, politikat hegjemoniste të Serbisë për ndarje të Kosovës janë aty. Në krahasim me pjesën jugore jeta e komunitetit serb në veri është në kontroll të plotë, jo vetëm të Listës Serbe apo edhe të elementeve të shtetit serb dhe strukturave të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe grupeve kriminale të cilat kontrollohen nga rrethi i ngushtë i presidentit Vuçiq”, ka thënë ai.

Peci ka deklaruar se pavarësisht retorikës së tensionuar nuk ka potencial për një konflikt të armatosur mes Kosovës dhe Serbisë.

Ai ka numëruar problemet kyçe për marrëveshjen mes Kosovës dhe Serbisë, derisa ka shtuar se e ardhmja e Kosovës varet edhe nga njohja e pesë shteteve anëtare të BE-së.



VAZHDON PUNIMET SEMINARI I 102-TË ROSE-ROTH I ASAMBLESË PARLAMENTARE TË NATO-S

E ardhmja e Ballkanit Perëndimor, anëtarësimi në institucionet e BE-së

Edhe të dielën në Prishtinë ka vazhduar punimet Seminari i 102-të Rose-Roth i Asamblesë Parlamentare të NATO-s, ku u diskutua për situatën në Kosovë ndër vite dhe gjendjen aktuale, si dhe informimit lidhur me situatën në rajon, duke përfshirë këtu luftën mes Rusisë dhe Ukrainës dhe krizën energjetike. Në këtë seminar u tha se ardhmja e Ballkanit Perëndimor është anëtarësimi në institucionet e BE-së

EPOKA E RE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 9 TETOR - Seminari i 102-të Rose-Roth i Asamblesë Parlamentare të NATO-s, ka vazhduar të dielën punimet me sesionet e parapara për ditën e dytë.

Deputeti Xhavit Haliti, anëtar i Delegacionit të Kuvendit të Kosovës në AP të NATO-s, në fjalimin e tij hyrës, duke e konsideruar mjaft të rëndësishëm dhe të frytshëm organizimin e këtij seminari, theksoi se si i tillë i shërben informimit publik për situatën në Kosovë ndër vite dhe gjendjen aktuale, si dhe informimit lidhur me situatën në rajon, duke përfshirë këtu luftën mes Rusisë dhe Ukrainës dhe krizën energjetike.

Duke iu referuar raportit midis Serbisë dhe Kosovës dhe politikave të deritashme në këtë drejtim, deputeti Haliti ftoi

kryeministrin e Republikës së Kosovës, Albin Kurti, për të prezantuar zhvillimet e fundit në vend dhe hapat konkretë të marrë në raport me këto zhvillime.

Duke marrë fjalën në seminar, kryeministri Albin Kurti theksoi rëndësinë e organizimit të këtij seminari, ndërsa veçoi rolin e NATO-s në promovimin e parimeve dhe vlerave demokratike, si dhe në vazhdimësinë e krijimit të politikave që ndërtojnë paqe dhe stabilitet në rajon dhe më gjerë.

Duke përmendur disa nga problemet me të cilat Ballkani ballafaqohet ende, kryeministri Kurti theksoi tendencat e regjimit serb për destabilizimin e vendit, në bashkëpunim të ngushtë me Rusinë, për të ndikuar kështu në vendet e tjera të rajonit e në këtë rast edhe në Kosovë.

Si rezultat i këtij përdorimi të

Rusisë për të kërcënuar lirinë dhe paqen e popullit të Kosovës, kryeministri Kurti tregoi se Kosova nën patronazhin e Brukselit tashmë është përfshirë në dialog konstruktiv për të arritur një marrëveshje detyruese që bazohet në njohjen e ndërsjellë. I pari i Qeverisë ndër të tjera potencoi se Kosova është e qartë në orientimin dhe vizionin e saj drejt integritetit të BE dhe NATO, pasi që prioriteti kryesor i Kosovës, siç tha ai, është promovimi i demokracisë, Bashkimi Evropian dhe mbrojtja sipas standardeve të NATO-s.

Kryeministri Kurti po ashtu

përmendi rolin e NATO-s në mbështetjen dhe monitorimin e ndërtimit të FSK-së, e cila tashmë, siç theksoi kryeministri, është bërë pjesë e disa organizimeve ndërkombëtare.

Po ashtu, kryeministri Kurti theksoi se institucionet e Kosovës i përcjellin me kujdes zhvillimet pas agresionit rus në Ukrainë.

Gjatë fjalës së tij kryeministri Kurti ritheksoi nevojën e përfshirjes së Kosovës në NATO. "Kosova është pjesë e rëndësishme e historisë së NATO-s dhe shteti i Kosovës e mbron fuqishëm suksesin e NATO-s në Kosovë", theksoi

kryeministri Albin Kurti.

Pas ekspozesë së kryeministrit Kurti, u zhvillua diskutim konstruktiv midis të pranishmëve, duke u fokusuar kryesisht tek raporti mes Serbisë dhe Kosovës, liberalizimi i vizave, të drejtat e njeriut, roli i NATO-s dhe tema të tjera nën temën qendrore të Seminarit të 102-të Rose-Roth të Asamblesë Parlamentare të NATO-s.

Në sesionin e parë të seminarit, hapur nga Philippe Folliot, kryetar i Komisionit të Ekonomisë dhe Sigurisë dhe Anëtar ex officio i Komisionit të Përhershëm, u diskutua lidhur me temën "Roli i të rinjve në ndërtimin e shoqërive të qëndrueshme, demokratike, multietnike dhe paqësore".

Folliot në cilësinë e moderatorit të këtij sesioni përmendi rëndësinë e temës së diskutimit, duke konsideruar se roli i të rinjve të Kosovës duhet të jetë baza themelore e zhvillimit ekonomik dhe sigurisë së vendit.

Më pas fjala i kaloi shefit të misionit të OSBE-së në Kosovë, Michael Davenport, i cili u shpreh se ky mision vazhdon të jetë i lidhur ngushtë me të drejtat në komunitet dhe stabilitetin e vendit. "Misioni ynë është i fokusuar shumë për rininë dhe të drejtat e njeriut, si



dhe barazinë gjinore. Jam impresionuar nga qasja që ka misioni në këto dy aspekte, sidomos kur nga statistikat e kuptojmë se rreth 53% e popullsisë së Kosovës përbëhet nga të rinjtë”, theksoi Davenport.

Megjithatë, kreu i OSBE-së nuk la pa ngritur edhe shqetësimet e tij lidhur me sfidat e të rinjve në Kosovë. Ai tha se gjithëpërfshirja, edukimi jo-formal, vendet e punës, ngritja e cilësisë së arsimit, janë disa nga sferat më fragile kur është fjala për zhvillimin e rinisë.

Më pas, panelisti Dushan Radakovic, drejtor ekzekutiv nga Qendra për Avokim dhe Kulturë, para të pranishmëve tha se organizata nga e cila ai vjen e konsideron të rëndësishme bashkëpunimin inovativ me të rinjtë.

Deri në përfundim të sesionit vëmendjen kryesore e mori diskutimi lidhur me raportet ndëretnike, si dhe pengesat të cilat duhet të kapërcehen për të arritur deri tek një rezultat i kënaqshëm sa i përket stabilitetit dhe demokracisë. Gjatë kësaj pjese pati pyetje dhe përgjigje të cilat i kontribuuan temës së diskutimit.

Seminari vazhdoi punimet nën udhëheqjen e zëvendës-presidentit të AP-së së NATO-s, Sverre Myrli, nga Norvegjia, duke trajtuar temën e sigurisë dhe stabilitetit të Ballkanit Perëndimor, si dhe duke u fokusuar te zhvillimet e brendshme dhe të jashtme. Gjithashtu edhe procesi i lehtësimit të dialogut nga BE-ja



Foto: Zoran Kryeministrit të Kosovës

ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës, ishte temë diskutimi në këtë pjesë të seminarit.

Lidhur me situatën në veri të Kosovës, si dhe integrimin e serbëve në Kosovë, drejtori ekzekutiv i Institutit Kosovar për Hulumtim dhe Zhvillim të Politikave (KIPRED), Lulzim Peci, theksoi se rreth 60 për qind e serbëve jetojnë në veri dhe se shumica prej tyre janë të integruar në jetën shoqërore, por megjithatë, shihet nevoja e arsimit dhe e punësimit.

Lidhur me zhvillimet e fundit në dialogun Beograd-Prishtinë dhe nevojën e ringjalljes së procesit të integrimit të Ballkanit Perëndimor, foli edhe Marko Prelec, konsulent analist i Lartë nga Grupi Ndërkombëtar i Krizave.

Prelec theksoi se procesin e dialogut duhet shikuar nga një perspektivë më e gjerë. Sipas tij, e ardhmja e Ballkanit Perëndimor është anëtarësimi në institucionet e Bashkimit Evropian dhe se procesi i integritit varet nga dialogu e jo

nga diçka tjetër.

Lidhur me kërcënimin për paqen, stabilitetin dhe integritetin e paraqitur nga rritja e nacionalizmit dhe separatizmit në Bosnjë dhe Hercegovinë, fjalën mori Adnan Cerimagic, analist i lartë i politikave nga Iniciativa Evropiane për Stabilitet në Berlin.

Gjatë diskutimit të tij Cerimagic tha se shpesh herë qarkullon përshtypja se Bosnja dhe Hercegovina është storie që nuk ka pasur sukses dhe të gjitha investimet kanë qenë të kota. Referuar kësaj narrative, Cerimagic theksoi se nuk duhet të nënvlerësohet të arriturat e BH e që nuk janë të pakta.

Rrugëtimin e këtij shteti për në BE ai e cilësoi proces të ngadalshëm, e që nuk po trajtohet drejtësisht dhe me seriozitetin e merituar. Ndërkaq, lidhur me sigurinë shtetërore, ai tha se Bosnja dhe Hercegovina është e kërcënuar nga Rusia, përkundër investimeve që janë bërë nga

komuniteti ndërkombëtar.

Implikimet e luftës në Ukrainë për Ballkanin Perëndimor ishte tema e radhës që u trajtua në këtë seminar. Haki Abazi, kryetar i Komisionit për Punë të Jshme, në hapjen e këtij sesioni tha se popujt e Ballkanit nuk e meritojnë këtë situatë.

“Ndikimi është i përmasave të llahtarshme dhe nuk kemi kohë për relaksim, prandaj, anëtarësimi në BE duhet të ndodhë, sepse kemi të bëjmë me sigurinë dhe stabilitetin e kontinentit”, theksoi ai.

Për të dhënë qëndrimet e qeverisë në këtë çështje, Donika Gërvalla, zëvendëskryeministre dhe ministre e Punëve të Jashtme, tha se ky seminar po mbahet në kohën e duhur, sepse, siç tha ajo, nevoja për bashkëpunim është e madhe.

Ajo gjithashtu përmendi mbështetjen që ka ofruar Kosova ndaj Ukrainës, sepse siç tha ajo, empatia e popullit të Kosovës ndaj atij ukrainas është e prezente për shkak ngjashmërisë së situatës. “Kosova është rreshtuar në radhën e shteteve lidere dhe mbështesim sanksionet e SHBA-ve ndaj Ruisë. E kuptojmë sepse të njëjtën gjë kemi kaluar me Serbinë dhe po vazhdojmë ta kalojmë, sepse Serbia ka probleme edhe me shtetet tjera fqinje”, theksoi zëvendëskryeministrja Gërvalla.

Sa i përket implikimeve gjeopolitike në Ballkanin Perëndimor të pushtimit të pajustificuar, të paprovokuar dhe të paligjshëm të Ukrainës nga Rusia, foli edhe Mark

Galeotti, drejtor në Mayak Intelligence.

Galeotti përmendi dëmet e shkaktuara nga kjo luftë, duke u fokusuar te dëmet ekonomike e shoqërore, kriza energjetike dhe ajo e ushqimit.

Në këtë mes, drejtori Galeotti, vuri në pah rolin dhe rëndësinë e Aleancës Veriatlantike.

Tutje, seminari vazhdoi punimet duke trajtuar temën e shtrirjes së implikimeve dhe atë të ndikimit të Ruisë në Ballkanin Perëndimor.

Me këtë rast, Sonia Biserko nga Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Serbi, theksoi se lufta në Ukrainë ka qenë përsheptuese, sepse Rusia ka intensifikuar përpjekjet e saj në Ballkanin Perëndimor.

Sipas Biserkos, e gjithë kjo që po ngjanë është rezultat i moskonsolidimit të mjaftueshëm të vendeve të rajonit dhe se kjo e ka bërë më të lehtë për Moskën që të shkaktojë trazira në Ballkan.

Gjithashtu ajo tha se është dëshmuar se Rusia qëndron prapa angazhimeve shkatërruese, duke i rënduar dhe komplikuar reformat në rajon. Sipas saj, Rusia mendon të ndalojë Serbinë dhe shtetet e tjera që të anëtarësohen në BE, në mënyrë që ta tregojë fuqinë e saj.

Pas diskutimeve të panelistëve, tema ngjalli interesim të shtuar te pjesëmarrësit, të cilët shtruan pyetje të shumta në adresë të diskutuesve.

Seminari vazhdon punimet edhe të martën.



Si mund t'i merrni fondet e Qeverisë për ngrohje eficiente?



PRISHTINË, 9 TETOR - Pak kohë para se të bien temperaturat në Kosovë dhe qytetarët të jenë të obliguar t'i ngrohin shtëpitë dhe banesat e tyre, Ministria e Ekonomisë ka prezantuar një plan për mbështetjen financiare të qytetarëve për blerjen pajisjeve për ngrohje që shpenzojnë më pak energji elektrike.

Janë disa lloje të pajisjeve që Qeveria do t'i subvencionojë përfshirë këtu: kaldajat me biomasë, pompat termike, kondicionerët eficientë dhe stufat individuale eficiente me biomasë. Sipas statistikave, më së shumti energji elektrike në Kosovë shpenzon sektori i amvisërisë, me rreth 40 për qind të konsumit të përgjithshëm.

Aplikimi në "thirrjen për mbështetje të qytetarëve në eficientë të energjisë" bëhet përmes platformës "ekosova", në seksionin "Grante dhe Subvencione".

Në total, Ministria e Ekonomisë e Kosovës ka ndarë 6 milionë euro për këtë thirrje. Me këto mjete synohet që të mbështesin 100.000 familje në blerjen e pajisjeve që ulin për gati 70 për qind konsumin e energjisë elektrike për ngrohje.

Si bëhet aplikimi dhe cilat janë kriteret teknike?

Të drejtë aplikimi për mbështetje në blerjen e pompës termike kanë të gjithë qytetarët që ngrohin shtëpitë e tyre me energji elektrike.

Personi që aplikon duhet të dëshmojë se të paktën në njërin prej muajve në mes të periudhës dhjetor 2021 - shkurt 2022 ka shpenzuar mbi 800 kilovat energji elektrike.

Nëse qytetari ka kursyer energjinë elektrike dhe nuk ka tejkaluar këtë shifër, atëherë sistemi ia refuzon aplikimin.

Një person që ka shtëpi të kyçur në ngrohoren e qytetit apo në ngrohje kolektive, po ashtu nuk mund të aplikojë. Shtëpia duhet të jetë e izoluar, të ketë dyer dhe dritare të plastikës apo aluminit si dhe duhet ta ketë të instaluar sistemin e ngrohjes qendrore.

Qytetari duhet të kujdeset që pompa termike që blen të ketë shkallë të lartë të eficientës, minimum duhet të jetë "A++".

Pajisjet që janë të shënuara me simbolet "A++" hyjnë në kategorinë e pajisjeve që konsumojnë më pak energji për të prodhuar nxehtësi. Koeficienti i performancës së pompës termike duhet të jetë 4.2 ose më i lartë, ndërkohë që koeficienti i performancës sezonale kërkohet të jetë 3.2 ose më i lartë.

Për pompa termike, shteti ndihmon me 30 për qind të vlerës që investohet, por jo më shumë se 2.500 euro. Mesatarisht, një pompë e mirë termike në Kosovë kushton prej 5.000 deri në 7.000 euro.

Subvencionimi për kondicionerë, 40 për qind

Qytetarët që ngrohin shtëpitë dhe banesat me energji elektrike dhe

që kanë shpenzuar më shumë se 800 kilovat në periudhën 30 dhjetor 2021 - shkurt 2022, mund të aplikojnë për subvencionim në blerjen e një kondicioneri. Banesa apo shtëpia, edhe në këtë rast duhet të jetë e izoluar dhe të ketë dyer dhe dritare eficiente. Po ashtu, nuk duhet të jetë e lidhur me ngrohoren e qytetit apo me ngrohje kolektive.

Kondicioneri që blihet duhet të jetë eficient minimum "A++". Koeficienti i performancës së pompës termike ajër-ajër duhet të jetë 4.0 ose më i lartë.

Vlera e ndihmës nga Qeveria e Kosovës për kondicionerë do të jetë 40 për qind e vlerës së investimit, por jo më e lartë se 400 euro.

Çmimi i këtij lloji të kondicionerëve dallon nga prodhuesi në prodhues, por momentalisht në tregun e Kosovës, pajisje të tilla eficiente fillojnë nga 400 deri në rreth 2.000 euro.

Financimi për kaldajat me dru, pelet dhe briket

Për këtë kategori nuk kërkohet që shtëpitë të jenë të izoluar apo të kenë dyer dhe dritare eficiente. Megjithatë vlen kriteri i shpenzimit të më shumë se 800 kilovatëve të paktën gjatë një muaji në periudhën 30 dhjetor 2021 - shkurt 2022.

Qytetarët që aplikojnë për të blerë një kaldajë të tillë, nëse kualifikohen, përfitojnë 70 për qind të vlerës që kanë investuar në blerjen e pajisjes, por nëse

çmimi është shumë i lartë, atëherë shteti mbulon maksimum 1.200 euro.

Mund të aplikohet edhe për stufa

Për këtë lloj mbështetje janë kriteret më të lehta. Nëse aplikojnë qytetarët që janë përfitues të skemave sociale, atyre iu financohet 90 për qind e vlerës së stufës, por jo më shumë se 560 euro. Ndërkaq, ata që nuk janë pjesë e skemave sociale përfitojnë 70 për qind të çmimit të blerjes së pajisjes, por jo më shumë se 435 euro.

Çfarë përfshin faza e dytë dhe si përfitohen mjetet financiare?

Qytetarët mund të aplikojnë për fazën e parë të subvencionimit deri më 20 tetor apo derisa të shpenzohen 6 milionë eurot e dedikuara për këtë thirrje.

Nëse qytetari i ka plotësuar kriteret për ndonjërin nga pajisjet dhe është kualifikuar për fazën e dytë, ai ka në dispozicion 21 ditë për të blerë pajisjen, për instaluar atë dhe për të aplikuar në fazën e dytë.

Në fazën e dytë kërkohet: fatura e rregullt apo kuponi fiskal i blerjes së pajisjes, vërtetimi i xhirologarisë bankare i lëshuar nga banka, fotografia e pajisjes së instaluar, fotografia e numrit serik të pajisjes, fotografia e etiketës së performancës së pajisjes.

Ndërkaq, për qytetarët që janë përfitues të skemës sociale dhe që kanë aplikuar për përfitim të subvencionit prej 90 për qind për stufën individuale me biomasë, kërkohet të ngarkohet një dëshmi që vërteton mbështetjen e skemës sociale.

Në shpallje bëhet e ditur se aplikimet e pranuar do të shqyrtohen bazuar në parimin "kush aplikon i pari, shërbehet i pari".

Por, e gjithë kjo nuk garanton se qytetari që ka investuar do t'i rimbursohen paratë, pasi vendim final do ta marrë një komision i Ministrisë së Ekonomisë.

Nëse komisionin pranon aplikacionin, nënshkruhet Marrëveshja e subvencionimit me Ministrinë e Ekonomisë dhe hapi i fundit është transferimi i mjeteve nga Qeveria në llogarinë e përfituesit.

Si në shumicën e vendeve të rajonit dhe Evropës, edhe në Kosovë është paralajmëruar dimër i vështirë për shkak të krizës energjetike.

Ekspertët dhe zyrtarët qeveritarë janë duke bërë thirrje vazhdimisht për kursim maksimal të energjisë elektrike. Në veçanti është duke u kërkuar që qytetarët të gjejnë forma alternative për ngrohje dhe të largohen nga energjia elektrike. Ndryshe, thonë ata, reduktimet e rrymës do të jenë të pashmangshme.

Efektet e para të krizës energjetike Kosova i përjetoi në verë, kur për disa ditë rresht pati reduktime të rrymës.

PDK-ja: Kosova po zbrazet e po varfërohet, qeveria Kurti po jeton jashtë realitetit ekonomik

**EPOKA
ERE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 9 TETOR - Koordinator i Departamentit për Financa në Kabinetin për Qeverisje të Mirë të Partisë Demokratike të Kosovës, Arben Mustafa, ka thënë të dielën në konferencë për media se të dhënat e paraqitura së fundmi nga qeveria e udhëhequr nga Albin Kurti për zhvillim ekonomik dhe punësim të 40 mijë qytetarëve, dëshmojnë se kabineti qeveritar është i shkëputur nga realiteti që po mbizotëron në Kosovë. Pasi ka demantuar me fakte se qytetarët e Kosovës gjatë këtij viti janë varfëruar dhe ekonomia ka shënuar rënie të madhe, Arben Mustafa e ka ftuar kryeministrin Albin Kurti që urgjentisht të zbrësë tek qytetarët në terren dhe do ta kuptojë shumë shpejtë realitetin. “Në kohën kur Kosova po shënon krizën më të rëndë ekonomike në 22 vitet e fundit, kur qytetarët po varfërohen çdo ditë e më tepër për shkak të rritjes së çmimeve dhe rritja ekonomike po bie me ritëm të shpejtë, Kryeministri i vendit paraqiti disa tregues përmes të cilëve po synon t’i bindë qytetarët se ata nuk po ballafaqohen me vështirësi ekonomike, por po e jetojnë një periudhë të lulëzimit të ekonomisë. Si duket, në këtë vend, vetëm kryeministri dhe vartësit e tij dhe askush tjetër besojnë se ekonomia e vendit po lulëzon”, tha Mustafa.

Ai tha se kryeministri Kurti po ashtu vazhdoi praktikën e vartësve të tij për t’i prezantuar zhvillimet ekonomike përmes treguesve nominalë. Sipas Mustafës, edhe njohësit më modestë të ekonomisë e kuptojnë shumë mirë që në kohë inflacioni, treguesit nominalë ofrojnë informacione të shtrembëruara dhe nuk e paraqesin realitetin, pasi që në llogaritje nuk përfshijnë efektin e inflacionit. “Kryeministri po deklaroi se ka krijuar 40 mijë vende të reja pune, por ndoshta e ka fjalën për Gjermaninë ose vendet tjera ku po imigrojnë të rinjtë tanë”, deklaroi Mustafa. Udhëheqësi i Departamentit për Financa në KQM ka paraqitur të dhënat zyrtare të ekonomisë në vend, të cilat sipas tij i demantojnë propagandat qeveritare. “Norma e inflacionit për produktet esenciale është mbi 20%, që do të thotë se paratë në duar e qytetarëve sot vlejnjë rreth 20% më pak sesa që kanë vlejtur para një viti. Në këtë normë të lartë inflacioni, kontribut shumë të rëndësishëm ka dhënë refuzimi i Qeverisë së Kosovës për të ndërmarrë masa fiskale që do ta frenonin rritjen e çmimeve. Norma reale e rritjes ekonomike në tremujorin e dytë të vitit 2022 ishte vetëm 2.1%, rritja e më e ulët e shënuar gjatë një tremujori të dytë që nga viti 2014, përjashtuar pandeminë në vitin 2020. Me këtë ritëm, si dhe duke pasur parasysh pritjet



për krizën e energjisë gjatë dimrit, ekonomia e vendit shumë lehtë mund të shkojë drejtë recesionit. Kjo do të nënkuptonte më pak vende pune dhe më pak të ardhura për qytetarët”, Mustafa. Ai tha se ndërprerjet e furnizimit të energjisë elektrike gjatë muajve të verës ishin paralajmërimi më i mirë për atë se çka po na pret gjatë dimrit. “Tani kur veç kanë filluar të bien temperaturat dhe është bërë vonë për çfarëdo reagimi, Qeverisë i bie në mend për të ofruar mbështetje për familjet vetëm sa për të figuruar në listën e veprimeve të Qeverisë dhe jo se pritet ndonjë efekt real

i atyre masave. Subvencionimi për blerjen e stufës së peletit nuk ka kuptim, kur çmimi i peletit është rritur për 300%”, tha ai. Ai tha se gjatë tre muajorit të dytë të këtij viti, Kosova ka shënuar rënie të investimeve të sektorit publik, rënie të investimeve të sektorit privat dhe rënie të sasisë së mallrave të eksportuara. Për sa i përket tregut të punës, Mustafa tha se Qeveria ende nuk ka publikuar asnjë statistikë zyrtare për vitin 2022, ndërsa bazuar në dinamikat aktuale të ekonomisë dhe migrimit të madh të të rinjve nuk ka arsye për të vlerësuar se tregu i punës

po kategorizohet me zhvillime pozitive. “Ndërsa, kryeministri i vendit, në vend se të kyçet seriozisht në debatin për menaxhimin e situatës së rëndë ekonomike, ai paraqitet para publikut me një komoditet të paparë, sikur ekonomia jonë të ishte në bum ekonomik dhe kjo krizë e rëndë të mos ekzistonte fare. Unë besoj se kryeministri i Kosovës e kupton mirë që ajo nëpër të cilën po kalon ekonomia e vendit nuk është progres, por është krizë e rëndë. Nëse me të vërtetë ende nuk po e kupton, atëherë duhet që urgjentisht të zbrësë te qytetarët dhe do ta kuptojë shumë shpejtë”, tha Mustafa.

Mbi 1 000 punëtorë të KEK-ut fitojnë kontestatin për paga shtesë për orët e punës gjatë fundjavës

PRISHTINË, 9 TETOR - Mbi 1 mijë e 200 punëtorë të KEK-ut kanë fituar në tri shkallshmëri betejën ligjore civile, të cilët e kishin nisur kundër të paditurës KEK në vitin 2012 për kompensimin e pagave shtesë për punën e kryer gjatë fundjavës. Punëtorët e Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK), kishin ngritur padi në vitin 2012, duke pretenduar se e paditura nuk i kishte kompensuar shtesë gjatë punëve të fundjavës për periudhën 1 tetor 2011 deri më 30 shtator 2017. Në aktgjykimin e siguruar nga “Betimi për Drejtësi”, rezultoi se Gjykata Themelore në Prishtinë ka gjetur se paditësit nuk ishin kompensuar për punën shtesë gjatë fundjavës, e drejtë kjo që iu takonte në bazë të nenit 56par.1 të Ligjit të Punës në të cilin ceket se “Të punësuarit i takon paga shtesë në përqindje të pagës bazë, si më poshtë: 20% në orë për kujdestari, 30% në orë për punë gjatë natës dhe punë jashtë orarit, 50% në orë për punë gjatë

ditëve të festave dhe 50% në orë për punë gjatë fundjavës”. Sipas arsytimit të aktgjykimin të Gjykatës Themelore, rezultoi se ishte provuar në bazë të kontratave të punës të vitit 2011 dhe nenit 39 të Kodit të Punës se ishte e paraparë kompensimi për orët shtesë për punën gjatë fundjavës. “Megjithatë nga provat e administruara gjykata ka gjetur se paditësit posedojnë kontratat e punës me të cilat argumentohet se të njëjtin punojnë me ndërrime, ashtuqë nga ekspertiza financiare është vërtetuar se ata kanë punuar edhe ditëve gjatë fundjavës (të shtunave dhe të dielave) varësisht prej kohës së punës përkatësisht ndërrimeve ndërsa e paditura nuk ua kompensuar 50% për orët për punë gjatë fundjavës e as nuk ua ka dhënë ndonjë ditë të lirë në emër të pagës shtesë”, thuhet në arsyetimin e vendimit. Gjykata ka gjetur se në bazë të ekspertizës financiare të gjithë paditësit kishin punuar me ndërrime dhe të njëjtit kishin punuar edhe gjatë ditëve të



fundjavës varësisht prej kohës së punës. “Sipas dispozitave ligjore një ndër të drejtat themelore të punëtorit është paga, në këtë

rast e drejtë themelore e paditësve është paga shtesë për punët e kryera gjatë fundjavës (të shtunave dhe dielave), sipas

dispozitave të nenit 55 të Ligjit të Punës, të cilin të drejtë paditësit nuk e kanë realizuar”, thuhet në arsyetimin e gjykatës.

Asnjë perandori nuk zgjat përgjithmonë, ja çfarë pritet të ndodhë me SHBA-në, Rusinë dhe Kinën



Nga Robert D. KAPLAN

Luftërat janë faktorë përcaktues në histori. Luftërat që shkojnë keq, dhe që shërbejnë si pika kulmore e një rënieje më të përgjithshme kombëtare, mund të rezultojnë fatale. Kjo është veçanërisht e vërtetë për perandoritë. Perandoria e Habsburgëve, e cila sundoi Evropën Qendrore për qindra vjet, mund të kishte mbijetuar pavarësisht dekadave në rënie, po të mos kishte qenë për humbjen e saj në Luftën e Parë Botërore.

E njëjta gjë është e vërtetë për Perandorinë Osmane, e cila që ka mes i shekullit XIX nisi të thirrej në nofkën e "E sëmurura e Evropës". Pra Perandoria Osmane, ashtu si ajo e Habsburgëve, mund të kishte ekzistuar edhe për shumë dekada, madje edhe të reformohej, po të mos ishte gjithashtu në anën e humbësve të Luftës së Parë Botërore.

Por nuk duhet të nënvlerësohen as pasojat e mëvonshme nga një gremisje e tillë perandorake. Perandoritë formohen nga kaosi, dhe rënia e tyre lë shpesh kaos. Shtetet më mono-etnike që u ngritën nga hiri i perandorive multi-etnike Habsburgase dhe Osmane, u treguan shpesh radikale dhe të paqëndrueshme. Kjo sepse grupime etnike dhe sektare dhe ankesat e tyre të veçanta, të cilat ishin mbajtur nën kontroll nën "ombrellat" e përbashkëta perandorake, papritur u vetë-përzien dhe u vunë përballë njëri-tjetrit. Në përgjithësi nazizmi dhe fashizmi ndikuan mbi shtetet dhe fraksionet radikale në Ballkanin post-Habsburgas dhe post-Osman, por edhe tek intelektualët arabë që studionin në Evropë, dhe që i morën me

vetë këto ide në atdheun e tyre të sapo-pavarësuar post-kolonial, ku ndihmuan në formësimin e ideologjisë katastrofike të Baathizmit.

Uinston Çerçill deklaroi në fund të Luftës së Dytë Botërore, se nëse monarkitë perandorake në Gjermani, Austri dhe gjetkë nuk do të ishin nëzuar nga vendimet e Konferencës së Paqes në Versajë "nuk do të kishte pasur asnjë Hitler".

Shekulli XX u formësua kryesisht nga rënia e perandorive dinastike në dekadat e para, dhe nga lufta dhe trazirat gjeopolitike pasuese në dekadat e mëvonshme. Perandoria nënçmohet shumë nga intelektualët, por rënia e saj mund të sjellë probleme edhe më të mëdha.

Për shembull Lindja e Mesme, nuk ka gjetur ende një zgjidhje të përshtatshme pas rënies së Perandorisë Osmane. Dhe kjo po shihet tek peripecitë e saj të përgjakshme gjatë 100 viteve të fundit. Kjo duhet mbajtur parasysh kur merret parasysh sot cenueshmëria e Kinës, Rusisë dhe Shteteve të Bashkuara.

Këto fuqi të mëdha mund të jenë edhe më të brishta nga sa duken. Deri më tani, Rusia dhe Shtetet e Bashkuara kanë nisur luftëra vetë-shkatërruese. Rusia në Ukrainë dhe Shtetet e Bashkuara në Afganistan dhe Irak. Sa i përket Kinës, fiksimi i saj me pushtimin e Tajvanit mund të çojë në vetë-shkatërrim.

Të treja fuqitë e mëdha botërore, kanë treguar gjatë viteve dhe dekadave të fundit periudha të një gjykimi shumë të keq në lidhje me mbijetesën e tyre afatgjatë. Nëse ndonjë apo të gjitha fuqitë e mëdha aktuale do të dobësohet shumë, konfuzioni dhe çrregullimi do të rritej jo vetëm brenda kufijve të tyre por edhe në mbarë botën. Një SHBA

e dobësuar, do të ishte më pak në gjendje të mbështeste aleatët e saj në Evropë dhe Azi.

Nëse regjimi i Kremlinit do të lëkundet për shkak të faktorëve që burojnë nga lufta në Ukrainë, Rusia, e cila në aspektin institucional më e dobët se sa Kina, mund të bëhet një version i ish-Jugosllavisë, e paaftë për të kontrolluar territoret e saj historike në Kaukaz, Siberi dhe Azinë Lindore.

Trazirat ekonomike ose politike në Kinë, mund të shkaktojnë trazira rajonale brenda vendit, por edhe të inkurajojnë Indinë dhe Korenë e Veriut, politikat e të cilave janë të kufizuara nga Pekini. Fuqitë e mëdha aktuale nuk janë perandori. Por Rusia dhe Kina ruajnë gjurmët e trashëgimisë së tyre perandorake.

Lufta e Kremlinit në Ukrainë, i ka rrënjët tek impulset që ekzistonin si në perandorinë ruse, ashtu edhe në atë sovjetike. Ndërkohë synimet agresive të Kinës ndaj Tajvanit, i bëjnë jehonë synimit të dinastisë Qing për të dominuar Azinë. Shtetet e Bashkuara nuk janë identifikuar asnjëherë zyrtarisht si një perandori.

Por zgjerimi drejt perëndimit në Amerikën e Veriut dhe pushtimet e herëpashershme territoriale jashtë shtetit, i dhanë SHBA-së një "aromë" perandorake gjatë shekullit XIX dhe në epokën e pas Luftës së Dytë Botërore, kur ajo ka gëzuar një nivel dominimi global që më parë njihet vetëm për perandoritë.

Sot, të treja këto fuqi të mëdha përballen me një të ardhme të pasigurt, në të cilën nuk mund të përjashtohet kolapsi apo edhe një shkallë shpërbërjeje. Gama e problemeve është e ndryshme për secilin, por sfidat me të cilat përballlet secili vend janë thelbësore për vetë ekzistencën e

asaj fuqie.

Rusia përballlet aktualisht me rrezikun më të menjëhershëm. Edhe nëse do të dominojë disi në luftën në Ukrainë, ajo duhet të përballlet me katastrofën ekonomike të shkëputjes nga BE dhe ekonomitë e G-7, në rast se nuk do të jetë një paqe të vërtetë, e cila tani për tani duket e pamundur.

Rusia mund të jetë tashmë "E sëmurura e Euroazisë", siç ishte dikur Perandoria Osmane për Evropën. Sa i përket Kinës, rritja e saj vjetore ekonomike ka ardhur duke u ngadalësuar nga të dhënat 2-shifrore në 1-shifrore, dhe së shpejti mund të arrijë në minimumin e dekadave të fundit.

Kapitali është larguar nga vendi. Investitorët e huaj po shesin miliarda dollarë në bono dhe aksione kineze. Po ashtu investimet nga jashtë janë zvogëluar, popullsia e saj është plakur, dhe fuqia punëtore ka rënë. E gjitha kjo nuk parathotë asgjë të mirë për stabilitetin e brendshëm të vendit në të ardhmen.

Shtetet e Bashkuara janë një demokraci, prandaj problemet e saj janë më transparente. Por kjo nuk i bën ato domosdoshmërisht më pak të mprehta. Fakt është se ndërsa deficiti federal po rritet në niveleve shqetësuese, vetë procesi i globalizimit i ka ndarë amerikanët në 2 grupime kundërshtarë: ata që janë pjesë e vlerave të një qytetërimi të ri kozmopolit mbarëbotëror, dhe ata që e refuzojnë atë për hir të një më botë më tradicionale.

Oqeanet janë gjithnjë e më pak një faktor në shkëputjen e Shteteve të Bashkuara nga pjesa tjetër e botës. SHBA-ja ishte një demokraci e madhe që funksiononte mirë në epokën e represionit në vende të

ndryshme. Por ajo ka shumë më pak sukses në epokën dixhitale, risitë e së cilës ushqyen zemërimin populist që çoi në zgjedhjet president të Donald Trump.

Për shkak të këtyre ndryshimeve, ka të ngjarë të ndodhë një konfigurim i ri i fuqisë globale. Sipas këtij skenari, Rusia do pësojë një rënie të shpejtë për shkak të luftës së saj të gabuar në Ukrainë. Kina do ta ketë shumë të vështirë të mbetet një fuqi të qëndrueshme ekonomike dhe teknologjike nën një Parti Komuniste Kineze, që po i rikthehet gjithnjë e më shumë leninizmit ortodoks.

Ndërkohë Shtetet e Bashkuara do të arrijnë të kapërcejnë trazirat e veta të brendshme, dhe do të rishfaqen si një fuqi unipolare, siç ndodhi menjëherë pas Luftës së Ftohtë. Një mundësi tjetër është një botë vërtet bipolare, në të cilën Kina e ruan dinamizmin e saj ekonomik edhe pse bëhet më autoritare.

Një skenar i tretë, është rënia graduale e të treja fuqive, duke çuar në një shkallë më të madhe anarkie në sistemin ndërkombëtar, me protagonizmin e fuqive të nivelit të mesëm, sidomos ato në Lindjen e Mesme dhe Azinë Jugore, dhe shtetet evropiane. Se cili skenar do të shfaqet, kjo do të varet shumë nga rezultati i garave ushtarake. Dhe këtu përfshihet edhe lufta në Ukrainë, por edhe përballja SHBA-Kinë mbi Tajvanin.

Shënim: Robert D.Kaplan, drejtues i departamentit të gjeopolitikës në Institutin e Kërkimeve të revistës "Foreign Affairs". / Marrë me shkurtime nga "Foreign Affairs" – Bota.al

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON Enverti
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE 'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Bashkimi triumfon në Superkupë

PEJË, 9 TETOR - Bashkimi ka triumfuar në Superkupën e Kosovës, duke mundur në finale Penzën me rezultat 63:70 (20:18, 16:21, 17:18, 10:13). Sfida në fakt ka qenë shumë interesante, ku vendaset ishin më të mira në periudhën e parë, por mysafiret

u kundërpërgjigjën në atë të dytë, duke shkuar në pushim me rezultat 36:39. Perioda e tretë ishte e baraspeshuar 17:18, duke bërë që ndeshja të vendoset në çerekun e fundit. Në dhjetë minutat e fundit, vashat prizrenase ishin më të mira dhe

më të vëmendshme, duke triumfuar 63:70. Medaljen e argjendta i kanë dorëzuar Komesari i Garave të FBK-së, Faton Kurshumlja dhe anëtar i Komisionit të Garave, Faton Kurshumlja, ndërsa medaljet e arta, nënkryetarja e FBK-së,

Linda Shala dhe anëtari i Bordit të FBK-së, Dardan Kasapolli. MVP i Superkupës është shpallur Arbnore Përçuku, çmim të cilin ia ka ndarë Linda Shala, që po ashtu dorëzoi trofeun te kapitenia e Bashkimit, Aulona Muhadri.



Short i favorshëm për Kosovën

PRISHTINË, 9 TETOR - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll ka pasur fat në shortin e tërhequr për kualifikimet e Kampionatit Evropian 2024, që të dielën në mesditë u tërhoq në Frankfurt. "Dardanët" janë përfshirë në Grupin I, duke iu shmangur top-gigantëve të futbollit evropian, teksa në grup do ta ketë Zvicrën, Izraelin, Rumaninë, Bjellorusinë dhe Andorrën. Në kualifikimet për "Euro 2024" janë 10 grupe: shtatë prej të cilave me pesë skuadra (Grupet A-G) dhe tre grupe me nga gjashtë ekipe (Grupet H-J). Ndashjet kualifikuese zhvillohen nga muaji mars deri në muajin nëntor të vitit të ardhshëm. Dhjetë fituesit e grupeve dhe dhjetë nënkampionët e grupeve kualifikohen drejtpërdrejt në turneun final, derisa tri vendet e mbetura do të plotësohen me skuadrat që kualifikohen në



'play-off' në mars të vitit 2024. Pas tërheqjes së shortit opinionet e tyre për verdiktin e shortit për faqen zyrtare të FFK-së i dhanë presidenti Agim Ademi dhe përzgjedhësi Alain Giresse. "Uroj që ta kemi ekipin

mirë me shëndet dhe pa lëndime në muajin mars. Grupi është korrekt. Ne duhet të bëjmë gjithçka që mundemi në të gjitha drejtimet për t'u kualifikuar. Është momenti ynë. Na priftë e mbara dhe pres përkrahjen e të gjithëve, të institucioneve, të Dardanëve, të komunitetit të futbollit dhe gjithë faktorit shqiptar në vend dhe sidomos Diasporës tonë. Kombëtarja e Kosovës është e të gjithëve pa dallim. Të gjithë e kemi të drejtën dhe rolin e barabartë në këtë pikë", ka theksuar presidenti Ademi. Ndërkaq, përzgjedhësi Giresse ka thënë se në bazë të këtij grupi mund të shpresohet për kualifikim. "Tani kemi verdiktin e shortit

dhe e kemi këtë grup dhe duhet të shohim si mund të kualifikohemi. Mund të ishte një grup më i vështirë, por nuk do të thotë se jemi të magjepsur. Sidoqoftë, mendoj se mund t'i japim vetes ambicien për të arritur një paraqitje të bukur në këtë grup. Sigurisht, do të kemi një ndeshje speciale e ajo është ndeshja kundër Zvicrës, pasi marrëdhëniet mes dy vendeve dhe mes dy popujve janë të veçanta. Tani na mbetet të përgatitemi mirë, t'i vëzhgojmë kundërshtarët tanë dhe të përgatitemi për të qenë në kushtet më të mira që nga muaji mars dhe për ta filluar këtë cikël kualifikimesh me ambicie", ka theksuar Giresse.

EURO 2024				
GROUP A	GROUP B	GROUP C	GROUP D	GROUP E
SPAIN	NETHERLANDS	ITALY	CROATIA	POLAND
SCOTLAND	FRANCE	ENGLAND	WALES	CZECHIA
NORWAY	REP. OF IRELAND	UKRAINE	ARMENIA	ALBANIA
GEORGIA	GREECE	N. MACEDONIA	TURKIYE	FAROE ISLANDS
CYPRUS	GIBRALTAR	MALTA	LATVIA	MOLDOVA
GROUP F	GROUP G	GROUP H	GROUP I	GROUP J
BELGIUM	HUNGARY	DENMARK	SWITZERLAND	PORTUGAL
AUSTRIA	SERBIA	FINLAND	ISRAEL	BOSNIA-HERZEG.
SWEDEN	MONTENEGRO	SLOVENIA	ROMANIA	ICELAND
AZERBAIJAN	BULGARIA	KAZAKHSTAN	KOSOVO	LUXEMBOURG
ESTONIA	LITHUANIA	N. IRELAND	BELARUS	SLOVAKIA
		SAN MARINO	ANDORRA	LIECHTENSTEIN

ORARI I NDESHJEVE TË KOSOVËS

25 MARS, 2023
20:45 Izraeli - Kosova
18:00 Bjellorusia - Zvicra
20:45 Andorra - Rumania
28 MARS 2023
20:45 Kosova - Andorra
20:45 Rumania - Bjellorusia, Zvicra - Izraeli
16 QERSHOR 2023
20:45 Kosova - Rumania
20:45 Bjellorusia - Izraeli, Andorra - Zvicra
19 QERSHOR 2023
20:45 Bjellorusia - Kosova
20:45 Zvicra - Rumania, Izraeli - Andorra
9 SHTATOR 2023
20:45 Kosova - Zvicra
18:00 Andorra - Bjellorusia
20:45 Rumania - Izraeli
12 SHTATOR 2023
20:45 Rumania - Kosova
20:45 Izraeli - Bjellorusia, Zvicra - Andorra
12 TETOR 2023
20:45 Andorra - Kosova
20:45 Bjellorusia - Rumania, Izraeli - Zvicra
15 TETOR 2023
20:45 Kosova - Izraeli
18:00 Zvicra - Bjellorusia
20:45 Rumania - Andorra
18 NËNTOR 2023
20:45 Zvicra - Kosova
18:00 Bjellorusia - Andorra
20:45 Izraeli - Rumania
21 NËNTOR 2023
20:45 Kosova - Bjellorusia
20:45 Rumania - Zvicra, Andorra - Izraeli

Derbi i takon Pejës, kampionët e Yllit shijojnë fitoren e parë

PEJË, 9 TETOR - Peja ka shënuar fitore në derbin ndaj Trepçës me rezultat 83:72 (18:19, 21:23, 22:17, 22:13), në xhiron e pestë të mirë dhe e fituan këtë pjesë ishte shumë interesante dhe u zhvillua në një super atmosferë, ku pejanët shënuan fitoren e pestë nga pesë ndeshje, kurse mitrovicasit pësuan humbjen e parë në elitë pas tri fitoreve. Çereku i parë ishte shumë interesant dhe e baraspeshuar, ku asnjëra

skuadër nuk arrinte të shpërthejë dhe përfundon 18:19. Edhe periudha e dytë ishte shumë interesante e me mbrojtje të fortë, ku herë njëra skuadër kalonte në epërsi e herë tjetra, ndërsa skuadrat shkuan në pushim me rezultat 39:42. Edhe në periudhën e tretë rezultati u barazua shumë herë, që e bëri ndeshjen shumë interesante dhe elektrizuese, ndërsa shifrat në semafor pas 30 minutash ishin 61:59. Sfida

u vendos në dhjetë minutat e fundit, ku pejanët ishin më të vëmendshëm dhe triumfuan 83:72. Te Peja u dalluan Brad Waldow me 19 pikë e shtatë kërcime dhe Rodney Purvis me 23 pikë e katër kërcime, kurse te Trepça u dallua Erjon Kastrati me 20 pikë e katër asistime. Golden Eagle Ylli ka shënuar fitoren e parë në këtë edicion, duke mundur Vëllaznimin me rezultat 81:70 (17:21, 29:18, 19:12, 16:19), në

xhiron e pestë të elitës së basketbollit. Çereku i parë ishte kryesisht e barabartë deri në fund, ku mysafirët ishin më të mirë dhe e fituan këtë pjesë 17:21. Por, më pas, kampionët treguan fuqinë, duke përmbysur rezultatin, për të kaluar në epërsi 42:32, ndërsa shkuan në pushim me shifrat 46:39. Therandasi vazhduan me lojë të mirë edhe në periudhën e tretë, duke thëlluar epërsinë, ndërsa



shifrat në semafor pas 30 minutash ishin 65:51. Në dhjetë minutat e fundit, vendasit menaxhuan lojën dhe epërsinë për të triumfuar 81:70.



Në pajtim me nenin 38 të Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK), Paneli për përzgjedhjen e anëtarit joekzekutiv të Bordit të BQK-së, publikon:

Shpallje

Për plotësimin e një (1) pozite të anëtarit joekzekutiv të Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës

Profili i kërkuar:

- Person me integritet dhe përgatitje universitare;
- Minimum dhjetë (10) vite përvojë profesionale ose akademike në fushat e ekonomisë, financave, bankave, kontabilitet apo çështje juridike;
- Njohuri në krijimin dhe monitorimin e zbatimit të politikave të rëndësishme të lidhura me misionin, objektivat dhe detyrat e BQK-së;
- Në mënyrë specifike të plotësojnë kushtet sipas nenit 40 të Ligjit nr. 03/L-209 për BQK-në;
- Njohja e gjuhës angleze paraqet përparësi.

Emërimi do të jetë për një mandat pesëvjeçar duke filluar nga data e emërimit.

Lista e kandidatëve që kualifikohen nga ana e Panelit do t'i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës, i cili do të përzgjedh një individ. Miratimi dhe emërimi për këtë pozitë do të bëhet nga Presidenti i Republikës së Kosovës në pajtim me nenin 84 paragrafi 27, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 38 paragrafi 2 të Ligjit nr. 03/L-209 për BQK-në.

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë një CV me detaje dhe një letër motivuese përmes email adresës vijuese: paneli@bqk-kos.org ose në dorë në zarf të mbyllur në arkivin e BQK-së, Rruga Garibaldi nr. 33 në Prishtinë, ose përmes postës në adresë të BQK-së: Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (shënim: për pozitën e anëtarit joekzekutiv të Bordit të BQK-së), Rruga Garibaldi nr. 33, 10000 Prishtinë, Kosovë.

Afati për aplikim është deri më 28 tetor 2022.

Vetëm kandidatët e të cilët i plotësojnë kushtet e konkursit do të thirren për intervistë.



U skladu sa članom 38. Zakona br. 03/L-209 o Centralnoj banci Republike Kosovo (CBK), Panel za izbor neizvršnih članova Odbora CBK-a, objavljuje:

Oglas

Za popunjavanje jednog (1) položaja neizvršnog člana Odbora Centralne banke Republike Kosovo

Zatraženi profil:

- Osoba sa integritetom i univerzitetskom spremom;
- Najmanje deset (10) godina profesionalnog ili akademskog iskustva u oblastima ekonomije, finansija, bankarstva, računovodstva ili pravnih poslova;
- Znanje u stvaranju i praćenju sprovođenja važnih politika povezanih sa misijom, ciljevima i zadacima CBK-a;
- Specifično da ispuni uslove iz člana 40. Zakona br. 03/L-209 o CBK-u;
- Znanje engleskog i drugih jezika je prednost.

Imenovanje će biti za mandat od pet godina počevši od datuma imenovanja.

Spisak kandidata kvalifikovanih od strane Panela biće poslat Skupštini Republike Kosovo, koja će odabrati po jednog pojedinca za svaki položaj. Odobrenje i imenovanje za ove položaje izvršiće predsednik Republike Kosovo u skladu sa članom 84. stav 27. Ustava Republike Kosovo i članom 38. stav 2. Zakona br. 03/L-209 o CBK-u.

Zainteresovani kandidati treba da dostavljaju CV sa detaljima i motivacionim pismom na sledeću e-mail adresu: paneli@bqk-kos.org ili ručno u zatvorenoj koverti u arhivi CBK-a, ulica Garibaldi br. 33 u Prištini, ili poštom na adresu CBK-a: Centralna banka Republike Kosovo (napomena: za mesto položaj neizvršnog člana odbora CBK-a), Ulica Garibaldi br. 33, 1000 Priština, Kosovo.

Krajnji rok za podnošenje prijave je 28. octobar 2022.

Na intervju će biti pozvani samo kandidati koji ispunjavaju uslove konkursa.

Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

www.facebook.com/gjeipuneshpejte

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

<p>- Dafina Kelmendi shpall të pavlefshme dokumentet e shkollës së mesme "Gjin Gazulli Prishtinë."</p> <hr/> <p>- Alejna Zurnagji shpall të pavlefshme dëftesat e kl VI- IX shfmu "Mati Logoreci" Prizren.</p> <hr/> <p>- Aulon Krasniqi shpall të pavlefshme diplomën shmt "11 Marsi" Prizren.</p> <hr/> <p>- Valton Muqaj shpall të pavlefshme diplomën dhe certifikaten shmt "11 Marsi" Prizren.</p> <hr/> <p>- Agim Braha shpall të pavlefshme diplomën shmt "11 Marsi" Prizren</p> <hr/> <p>- Shkelzen Raçi shpall të pavlefshme dëftesat nga viti i I,II,III,IV si dhe Diplomën e shkollës së mesme "Gjin Gazulli" Prishtinë.</p> <hr/> <p>- Qendrim Gashi shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën shmt "11 Marsi" Prizren.</p> <hr/> <p>- Qendrim Gashi shpall te pavlefshme dëftesat shm " Skender Laurasi " Suhareke.</p>	<p>- Muharem Eger shpall te pavlefshme diplomën shmt "11 Marsi " Prizren.</p> <hr/> <p>- Hamro Rama shpall te pavlefshme dëftesat shmt "11 Marsi " Prizren.</p> <hr/> <p>- Muharem Rama shpall te pavlefshme dëftesat shmt "11 Marsi " Prizren.</p> <hr/> <p>- Zylfi Gutaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfmu " Luigj Gurakuqi " Nashec.</p> <hr/> <p>- Valtin Muqaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX shmu " Dëshmorët e Kabashit " Korishe.</p> <hr/> <p>- Visar Kryeziu shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shfmu " Xhevat Berisha " Prizren.</p> <hr/> <p>- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.</p>
---	---

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156
+386 49 848 553

PRISHTINË



ROYAL CROWN
RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales